

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtarës së vetëme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.R. nga ..., për shkak të 2 veprave penale vjedhje e pyellit nga neni 285 parag.1 i KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK-së nga Gjilani PP.nr.2205/2011 të dt.28.09.2011, në shqyrtimin e hapur gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Esat Ademi, të akuzuarit N.R., më dt.18.03.2014 komunikoi, ndërsa më dt.31.03.2014 përpiloi këtë,

## A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i ,

N.R., në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më pare për vepër tjetër penale, udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### ë s h t ë f a j t o r

#### I

Sepse më datë 21.08.2011, rreth ores 21.00 , në teritorin e e ..., me qëllim vjedhje në pyellin e pronës shoqërore, në vendin e quajtur “Par.39-40” të administruar nga APK-ja, zyra në Gjilan, me sharrë motorike I ka prerë rreth 4 m<sup>3</sup> trungje të njoma të bungut, me çka e ka dëmtuar A.P.K- zyra në Gjilan.

#### II

Sepse më datë 09.08.2011, rreth ores 05.30 , në teritorin e..., me qëllim vjedhje në pyellin e pronës shoqërore, në vendin e quajtur “Par.37-38” të administruar nga APK-ja, zyra në Gjilan, me sharrë motorike i ka prerë rreth 3m<sup>3</sup> trungje të njoma të bungut, me çka e ka dëmtuar A.P.K- zyra në Gjilan.

- me çka ka kryer dy vepra penale vjedhje pyelli në vazhdim, të parashikuar nga neni 285 parag.1 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u mbështetur në nenin 4,41,50,51,52,73,75 dhe neni 365 të KPPRK-së,, të akuzuarit i shqipton,

### Dënim me kusht

Ashtu që gjykata të akuzuarit për dy veprat penale (dispozitivi I dhe II) i cakton nga dy muaj burgim, ndërsa me aplikimin e nenit 80.par.2.pika 2.2 të KPK i shqipton dënim unik

burgimi në kohëzgjatje prej tre(3) muajve , ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse i akuzuari mbrenda afatit prej një viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen vepër tjetër penale, mbrenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

E dëmtuara A.P.K zyra- në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil .

I akuzuari obligohet që në emër të paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej 15 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Publike Komunale në Gjilan, me aktakuzën PP.nr.2205/2011 të dt.28.09.2011 ka akuzuar N.R. nga ..., për shkak të dy veprave penale të vjedhjes së pyellit nga neni 285 parag. 2 i KPK-së, pran të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përpudhje me ligjin.

I akuzuari në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se nga roja e pyllit dy herë është gjetur duke vjedhur dru në pyll, por ka kontestuar sasinë e drunjtëve të prera që atij i vëhet në ngarkesë , ka shtuar se ; se roja e pyllit , ka dashtë ta arsyetoj vetën për dëmin e shkaktuar në pyll nga persona tjetër dhe e ka ngarkuar atë me këtë sasi, më tej ka theksuar në mbrojtjen e tij se roja nuk e ka takuar në pyll duke prerë drunjët , por diku 300 metra, nga vendi i prerjes duke i transportuar drunjët.

Dëshmitari –roja e pyllit N.A. në dëshminë e tij ka deklaruar : më dt. 21.08.2011 rreth orës 21.00 kamë takuar të akuzuarin duke dalë nga pylli te vendi i quajtur “paralelja 39-40”, me traktorin e tipit traktorit me rimorkio të adaptuar, vendi ku është takuar i akuzuari nga vendi i prerjes ka qenë larg 100-150 m.Në rimorkio përfaqësisht kanë qenë 4 metra drunjë. Në vendin e prerjes ishin të prera përfaqësisht 7-8 m, mirëpo pjesa tjetër ishte bartur nga vendi i prerjes .Ka deklaruar se të akuzuarin e ka takuar në pyll edhe më dt.09.08.2011, rreth orës 05.30 min në territorin e ... në vendin e quajtur “Bagrem” paralelja 37-38, me drunjë të njoma bunge rreth 3 metra të ngarkuar, të akuzuarin e ka takuar rreth 100-150 metra larg vendit i prerjes. Ndërmarrja e pyjeve për këtë ka formuar një komision i cili në bazë të trungjeve të prera në vendin e prerjes ka kalkuluar edhe lartësinë e dëmit që u është shkaktuar.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se i akuzuari kishte prerë – vjedhë dru në pyllin në pronësi të të dëmtuarës në vendin kohën si në dispozitivin e aktgjykimit .

Këtë rrethanë e pohon i akuzuari e provon edhe dëshmitari me dëshminë e tij , por edhe rezulton nga provat tjera që ndodhen në shkresat e çështjes , kontestuese është sasia e drunjtëve të prera , në dispozitivin e aktakuzës theksohet se i akuzuari kishte prerë 20.31 m. përkatësisht 22.31.m, mirëpo pylltari i cili e kishte takuar të dëmtuarin në dy raste ka deklaruar se të akuzuarin e kishte takuar larg vendit të prerjes, herën e parë në rimorkio kishte katër(4) metra cub, ndërsa herën e dytë tri(3) metra cub, por sipas tij në vendin e prerjes kishte më shumë dru të prera dhe ai supozonte se edhe sasinë tjetër të drunjtëve të prera i kishte prerë vet i akuzuari, por drunjët i ka transportuar më herët.

Gjykata sa i përket vëllimit të drunjtëve të prera e pranoi dëshminë e rojës së pyllit si objektive dhe të bazuar , vetëm për sasinë që i pandehuri e kishte të ngarkuar në dy raste në rimorkio e tij, por jo edhe për pjesën tjetër që ishte e prerë në atë pjesë , ngase në mungesë të provave , prerësi i drunjtëve tjera( sasisë tjetër ) mund vetëm të supozohet por nuk mund të vërtetohet përtej çdo dyshimi, në këtë drejtim gjykata edhe konkretizoi dispozitivin e aktakuzës ( si në dispozitiv të aktgjykimit) duke mos cenuar identitetin objektiv të saj , ngase gjykata pa e prekur substratin faktik të aktakuzës, në bazë provave të proceduara, mban të drejtën që të bëjë konkretizimin e elementeve të caktuara .

Nga faktet që u parashtruan më parë , qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të dy veprave penale vjedhje e pyllit ( në bashkim real) të kryera në vazhdim, të parashikuara nga neni 285.par.1.të KPK.

Gjykata ka bërë ricilësimin e veprës penale në paragrafin 1. për faktin se nga provat që u proceduan (siç i arsyetua më lart) , nuk rezulton se i akuzuari kishte prerë sasinë e drunjtëve të theksuara në dispozitivin e aktakuzës , ndërsa në rastin konkret vëllimi drurorë ishte element kualifikues nga paragrafi 2 të nenit të cituar.

Me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori: Ka pranuar fajësinë dhe është penduar për veprën e kryer është mbajtës i familjes , ka gjendje të varfër ekonomike, nga dëshmohet nga kartoni për shfrytëzimin e ndihmës sociale, sjellja korrekte e tij në gjykatore dhe se nuk ka qenë i dënuar më pare, ndërsa rrethana rënduese ndaj ti nuk gjeti. Për këtë arsye kjo Gjykatë vlerëson se në rrethana të tilla edhe vetëm

kërcënimi me dënim, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit në segmentin prevencionit individual dhe gjeneral .

E dëmtuara A.P.K-ja zyra në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil, konform nenit 463 të KPRK-së, pasi që gjykata nuk kishte prova të mjaftueshme për gjykimin e plotë apo të pjesshëm të kërkesës pasurore-juridike në këtë procedurë. Vlerësimin e dëmit e ka bërë vet e dëmtuara, në situata të tilla (për të evituar dyshimin në paanësi) ekspertizën përkitazi me lartësinë e dëmit, duhet bërë nga eksperti i pavarur, në rastin konkret gjykata nuk ka mundur ta urdhëroj ekspertizë në këtë procedurë, për shkak se kjo do merrte kohë dhe do ndikonte në zvarritjen e procedurës penale.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN- DEGA NE KAMENICE,

Më datën 31.03.2014.

Procesmbajtësja

Gj y q t a r j a

\_\_\_\_\_  
Emine Zubaku,d,v

\_\_\_\_\_  
Valbonë Dërvodeli,d.v.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.